


## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT



Një ankesë kundër: Agjencia Qendrore e Prokurimit  
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit: UA/2016-18-3785-1-1-1  
Nr i brendshëm: AQP/18/001/111

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për "Furnizim me pajisje të TI, Ri-tender"  
(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

### ANKESË

PËR: LOT 1

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**Novus SHPK**  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Zenel Salihu nr.28**  
(Adresa)  
**Prishtinë, Kosovë**  
(Vendi)

10000  
(Kodi postar)

**+38649609000**  
(Numri Telefonit)

N/A  
(Numri i Faks-it)

**Leonora Mehmetaj**  
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Leonora.mehmetaj@novusconsult.net  
(Adresa elektronike)

20 Qershor 2019  
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vëla)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Zyra “Ramaj & Palushi” LLC, Avokat Kushtrim Palushi, Visar Ramaj  
(Emri i avokatit)

Rruga “Hyzyri Talla”, Z.P. Hyrja 6, Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë.  
(Adresa e plotë)

+377 44 210 889; +386 49 525 222  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

[info@ramajpalushi.com](mailto:info@ramajpalushi.com); [fis.salihu@gmail.com](mailto:fis.salihu@gmail.com), [kpalushi@ramajpalushi.com](mailto:kpalushi@ramajpalushi.com),  
(Adresa elektronike)

20.06.2019  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” apo “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

09.08.2018 – Është bërë Publikimi i Njoftimit për Kontratë.

Afati për dorëzimin e tenderit ka qenë data 05.10.2018, ndersa procesi i Hapjes së Tenderit është bërë me datën 05.10.2018, në ora 13:00.

05.06.2019 – Autoriteti Kontraktues AQP mori Vendim për Anulimin e aktivitetit të Prokurimit me arsyetimin se “specifikimi teknik është në kundërshtim me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenet 28.2; 28.7, si dhe me: “Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik nenet 20.3; 20.4 dhe 20.8 dhe si rezultat i kësaj është vendosur sipas Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, nenit 62 paragrafi 1.1., që të anulohet ky aktivitet”.



Me datën 10.06.2019, OE Ankues paraqiti Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108A, paragrafi 3.3., të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës sikurse është ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, për shkak të Vendimit të AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Me datën 14 Qershor 2019, AK mori Vendim për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim të OE Novus SHPK, me arsyetimin se “AQP ka vendosur të ju besoj ekserptë të IT që specifikat teknike kanë minimizuar konkurrencën e drejtë dhe si pasojë e kësaj të gjithë OE që i plotësojnë specifikat teknike ofrojnë në shumë raste produkt të njëjtë nga i njëjti prodhues dhe për më tepër vetëm një model edhe të atij prodhuesi”. Më tutje AK arsyeton se “në këtë aktivitet të prokurimit ka ndodhur gabim në përpilimin e specifikave teknike duke ngushtuar tregun dhe duke diskriminuar brendet me shtrirje globale që njëkohësisht kanë shtrirje të madhe edhe në tregun e Kosovës. AQP konsideron që në pamundësi për ti rregulluar këto lëshime që kanë ndodhur në dosjen e tenderit e vetmja mundësi ka mbetur që të anulohet ky Aktivitet i Prokurimit dhe pas përmirësimeve të ritenderohet.”

20 Qershor 2019 – Paraqitet kjo Ankesë në OSHP.

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	<input checked="" type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------

Nuk ka Ankesa në Procedurën e Hapjes së Ofertave.

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	<input checked="" type="checkbox"/>				Jo	<input type="checkbox"/>
----	-------------------------------------	--	--	--	----	--------------------------

--

#### 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe

*nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Me rastin e Anulimit të Aktivitetit të Prokurimit AK ka shkelur dispozitat në vijim të LPP-së:**

**Neni 28 – Specifikimet teknike**

**Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve**

**Neni 62 – Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit.**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## **7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Kjo Ankesë paraqitet me respekt kundër Vendimit për Anulim të Aktivitetit të Prokurimit me titull **“Furnizim me pajisje të TI, Ri-tender”** me numër të aktivitetit të tenderimit UA/2016-18-3785-1-1-1 dhe numër të brendshëm AQP/18/001/11. Aktiviteti i Prokurimit ka qenë i ndarë në dy (2) lote të cilat kanë përfshirë furnizimin me pajisje të ndryshme të TI-së për nivelin qendror dhe nivelin lokal.

Autoriteti Kontraktues AQP ka marrë Vendimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit në kundërshtim me nenin 62, paragrafi 1.1., të Ligjit për Prokurim Publik, për arsye se Dosja e Tenderit dhe Specifikimet Teknike të përmbajtura në të kanë qenë në përputhje me nenin 28 të LPP-së dhe kanë mundur të gjithë operatorëve ekonomik të paraqesin oferta të përgjegjshme.

Fillimisht dhe para se gjithash, në përputhje me Nenin 108 të LPP-së, ekziston afati ligjor për paraqitjen e Ankesave në lidhje me Kërkesat dhe Specifikatat teknike, kjo në periudhën para dorëzimit të ofertave. Në këtë drejtim, ka pasur Kërkesa për Rishqyrtim dhe modifikime të Kërkesave të Dosjes së Tenderit, të cilat kanë bërë të rritet konkurrenca. Si rrjedhojë, pas inkorporimit të ndryshimeve, nuk ka pasur asnjë Ankesë shtesë për Specifika teknike.



Në fazën para dorëzimit të ofertave, nuk ka pasur asnjë pretendim të Operatorëve Ekonomik për kërkesa diskriminuese.

Përfundimisht, nuk mund të ketë Dosje Diskriminuese kur në kuadër të dy Loteve ka pasur disa oferta të përgjegjshme të Operatorëve të ndryshëm ekonomik.

Fakti se Dosja e Tenderit ka qenë në përputhje me nenin 28 të Ligjit të Prokurimit më së miri dëshmohet me faktin se kanë qenë së paku 5 operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur oferta të përgjegjshme për Lot 1 dhe/ose Lot 2 të Aktivitetit të Prokurimit. Prandaj, në rastin konkret nuk ka pasur bazë ligjore për konstatimin se specifikimet teknike janë në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së, kur 5 operator ekonomik kanë qenë në gjendje të paraqesin oferta të përgjegjshme. Një vendim i tillë rrezikon t'i diskriminojë këta 5 operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur oferta të përgjegjshme në raport me operatorët e tjerë të papërgjegjshëm.

Në këtë mënyrë, Anulumi i Aktivitetit Tenderues paraqet veprim diskriminues në kundërshtim me Nenin 62 të LPP-së.

AK, më tutje në Vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim si të pabazuar ka përdorur një arsyetim shabllon për të gjitha Kërkesat për Rishqyrtim të paraqitura nga ana e OE të ndryshëm duke mos u përgjigjur në pretendimet specifike të operatorëve ekonomik specifik.

Prandaj, bazuar në argumentet dhe shkeljet e elaboruara më lartë, OE NOVUS ShPK kërkon me respekt nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që të merr këtë:

#### **VENDIM**

- I. **APROVOHET** Ankesa e OE NOVUS si e bazuar dhe lënda kthehet në rivlerësim dhe rivendosje.

#### **8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:*

Në rast të anulimit të tenderit në situatën kur OE Ankues ka qenë ofertues i përgjegjshëm dhe ka paraqitur ofertë që në rrethana të trajtimit të drejtë do të shpallej fituese, OE Ankues NOVUS ShPK do të pësojë dëme të konsiderueshme materiale dhe jomateriale, sikurse fitim të humbur dhe prishje të reputacionit afarist.

#### **9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*